




- Shoqata për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur nga trojet e veta - Prishtinë
- Komuna Hani i Elezit
- Produksioni uniART Creative - Prishtinë
- SHKAL "Naim Frashëri" - Fushë-Kosovë
- Shoqata e Shkrimtarëve "ABC Poetike" - Shkup



## MARRVESHJE BASHKËPUNIMI

Për realizmin e Manifestimit tradicional Eksodi "Bllaca '99"

-I-

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi lidhet mes palëve me qëllim të realizimit sa më mirë të Manifestimit tradicional Eksodi "Bllaca '99", i cili organizohet çdo vit më 10 Prill, në Han të Elezit, për t'i përkujtuar ditët e vështira të dëbimit me dhunë të popullatës civile nga trojet e veta.

-II-

Manifestimi do të mbahet në Han të Elezit më 10 Prill; Ora letrare në Qendrën Përkujtimore "Bllaca '99", duke përkujtuar dëbimin e popullatës gjatë vitit 1999 (24 poezi për 24 vjetorin), kurse ndarja e Çmimit "Hasan Prishtina", për 20 Komuna e Bashkësi lokale që ndihmuan e strehuan popullatën shqiptare të dëbuar me dhunë nga forcat ushtarake e policore serbe, do të organizohet në Qendrën Kulturore.

-III-

Çmimi "Hasan Prishtina" do tu ndahet: Komunave dhe disa Bashkësive lokale e fshatrave të RMV buzë kufirit me Republikën e Kosovës si dhe disa Shoqatave humanitare e disa mediave të RMV-së:

- Komunës Hani i Elezit,
- Komunës Çair - Shkup,
- Komunës Saraj - Shkup,
- Komunës Haraqin - Shkup,
- Komunës Studeniçan - Shkup,
- Komunës Likovë - Kumanovë,
- Komunës Tetovë,
- Komunës Gostivar,
- Komunës Kërçovë
- Komunës Dibër
- Komunës Strugë
- Komunës Rozhajë - Mali i Zi
- Komunës Ulqin - Mali i Zi
- Fshatit kufitar Bllacë
- Fshatit kufitar Nigishtan
- Fshatit kufitar Radush
- Fshatit kufitar Jazhincë
- Shoqata e Kryqit të Kuq-Shkup
- RTVMV -Programi në gjuhën shqipe
- Radio Shkupit programi shqip
- Radio "Vati"
- Gazetës "Fakti"
- Shoqata humanitare "El-hilall"
- Bashkësisë Islame në RMV.



-IV-

Shoqata për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur nga trojet e veta-Prishtinë, z. Jahja Lluka, do të përkujdeset për punën dhe pagesën e shtypit të çmimeve për të gjitha komunat dhe tjera të cekura si në pikën -II- të këtij Memorandumi, duke i bërë përgatitjet paraprake dhe mënyrën e ndarjes së çmimeve, më 10 Prill.

Z. Jahja Lluka, Kryetar i Shoqatës, do të veproi konform skenarit të përgatitur për ndarjen e çmimeve, në koordinim me nikoqirin z. Mehmet Ballazhi, Regjisorin Dibran Fylli, z. Asllan Qyqalla dhe z. Vullnet Sadiku, si dhe cakton personat që do t'i japin çmimet "Hasan Prishtina".

-V-

Komuna Hani i Elezit, gjegjësisht Kryetari i Komunës do të përkujdeset për sigurimin e Mjeteve të zërimit, skenës të Qendra përkujtimore "Billaca '99", ose sallës në Qendrën e Kulturës (në rast të motit me shi). T'u bëjë ftesa, ti pret e përcjellë mysafirët e ftuar nga Kosova dhe RMV, të cilët do të nderohen me çmimin "Hasan Prishtina", t'i nderoi me një drekë modeste. T'u bëjë ftesa zyrtare mediave nacionale e lokale për ta përcjellë Manifestimin tradicional Eksodi "Billaca '99" dhe ceremoninë e ndarjes së çmimit "Hasan Prishtina", si dhe të angazhoi Ansamblin e këngëve dhe valleve nga Hani i Elezit për një program të shkurtër artistik.

-VI-

Produksioni uniART Creative, regjisorin Dibran Fylli do të përkujdeset për dizajnin e Çmimit "Hasan Prishtina", Mirënjohjeve, Falënderimeve dhe materialeve tjera reklamuese për Manifestimin tradicional Eksodi "Billaca '99". Do ta bëjë shpërndarjen e informacionit, programit dhe ecurive të përgatitjeve në web faqen Orfeu.AL dhe portale tjera së paku 30 ditë para fillimit, si dhe ta bëjë regjistrimin me kamera, për arkivin e Shoqatës.

-VII-

SHKAL "Naim Frashëri", z. Asllan Qyqalla dhe SHSH "ABC Poetike" nga Shkupi, z. Vullnet Sadiku, do të përkujdesen për mbajtjen e Orës letrare "24 poet-24 poezi për 24 vjetorin". Do të shpallin konkurs për dërgimin e poezive, do të angazhojnë një Juri profesionale për përzgjedhjen e 24 poezive më të mira të konkursit, nga të cilat do të nderohen me Mirënjohje tri (3) vendet e para. Vlerësimi i punimeve do të bëhet paraprakisht, si dhe përkujdesen për mirëmbajtjen e Orës letrare më 10 Prill.

-VII-

Marrëveshja e bashkëpunimit hynë në fuqi pasi të nënshkruajnë palët si dhe palët janë të obliguara t'i përmbahen zotimeve të shkruara sipas pikave në këtë marrëveshje.

Marrëveshjen e nënshkruar:

1. Mehmet Ballazhi, Kryetar i KK Hani i Elezit






2. Jahja Lluka, Kryetar i SHSH



3. Dibran Fylli, Regjisor i UAC



4. Asllan Qyqalla, Kryetar i SHKAL



5. Vullnet Sadiku, Kryetar i SHSH "ABC"



Prishtinë

13/09/2022